# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-394135**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Protesta në SHBA tremb Berishën - Ndryshon vendin e takimit, emigrantët: Do t'i shkojmë kudo që të jetë |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/protesta-ne-shba-tremb-berishen-ndryshon-vendin-e-takimit-emigrantet-do-i584115` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 5 shtator 2026, 13:32:19 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 5 shtator 2026, 14:15:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `cee61bb47fbad24a368d43a03a71182ac4ea2707041476e7ec957a7713c0f162` |
| TEKSTI | `e8b557e1c8b421507ea73db4f2493f8ff4a97d1dc2581f322fd51bcdfcb60b47` |
| PAMJA | `0dd644295d58628c8883974e225d6fc4bbc3c630cffd4ccb6a12093f5e01963d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a0a44d8e7728452bf0946fc6c48ab10d08339963dfbbdd385afa19fb9996e21f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326` |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 46991200 |
| TRANSAKSIONI | `0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3` |
| IPFS | `QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz` |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a0a44d8e7728452bf0946fc6c48ab10d08339963dfbbdd385afa19fb9996e21f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Protesta në SHBA tremb Berishën - Ndryshon vendin e takimit, emigrantët: Do t'i shkojmë kudo që të jetë


TemA

5 Shtator 2026, 16:15Politika TEMA


---




Sali Berisha e nis me këmbën e majtë përtej oqeanit. Frika e një proteste kundër tij në takimin me demokratët në Nju Xhersi ka sjellë anulimin e aktivitetit në godinën e "Bergen Performing Arts Center" dhe zhvendosjen e takimit në një lokacion tjetër.

Organizatori i protestës kundër Sali Berishës, emigranti shqiptar në SHBA, Jurgen Boduri, përmes një videomesazhi ka denoncuar zhvendosjen e takimit të doktorit.

"Sapo kemi marrë informacionin se është ndryshuar vendndodhja e takimit të Sali Berishës me militantët dhe simpatizantët në Nju Xhersi. Nuk e di pse ka ndodhur ky ndryshim në momentin e fundit, dy ditë përpara takimit. Ndoshta frika e një proteste të madhe, e një organizimi që do të tregojë dhe nxjerrë në pah që Berisha nuk është i mirëpritur dhe është 'non grata' nga shqiptarët e Amerikës. Pavarësisht se Amerika mund t'ia ketë hequr, gjë që akoma nuk është deklaruar 100%."

Por Berisha nuk do ta ketë të lehtë. Organizatori paralajmëron se, sapo të informohet për lokacionin e ri, do të organizohet protesta kundër kryetarit të PD-së.

"Por këto detaje të takimit, që janë ndryshuar dy ditë para eventit, po mbahen sekrete. Patjetër që ne kemi njerëz të brendshëm për të mësuar se ku do të mbahet takimi. Sa më shpejt ta kemi këtë informacion, do ta shpërndajmë, që të gjithë ta marrin vesh dhe të mblidhemi që ta presim Sali Berishën ashtu siç e meriton."

Bie në sy se Jurgen Boduri, së bashku me personat që etiketon në rrjetet sociale për protestën kundër Sali Berishës, janë përkrahës të protestës së "flamingove" në bulevardin e Tiranës. Ai madje thotë se ka persona të infiltruar në grupin organizator të takimit të Berishës në Nju Xhersi.

Tashmë, Berishës shuplaka nuk po i vjen më nga SHBA-ja. Ata ia dhanë vizën. Vizën po ia heqin këtë herë "flamingot" që mbështeti në Tiranë kundër SHBA-së.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rama reagon për varrimin e Ratko Mlladiç! Mesazh Serbisë: Kasapi s'mund të përcillet me funeral shtetëror]

15:05 Politika

Hoxha pret ambasadoren e re të BE-së: Zgjerimi, një sukses i përbashkët

14:35 Politika

[Dash Shehi: Vajtja e Berishës në SHBA nuk ndryshon gjë për opozitën, si do ta rrëzojë Ramën kur ka probleme me SPAK]

14:15 Politika



['Të dëgjojnë babanë dhe nënën', Rama me batuta për zgjerimin e BE-së: '7 fëmijët e Ursulës' të ulen në tryezë! Ja si duhet të funksionojë integrimi gradual]

14:05 Politika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.